

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uellsi dhe Irlanda e Veriut shkaktojnë "tërmet" në Britaninë e M adhe
ADRESA	https://piranjat.al/bota/mbreteria-e-bashkuar-po-dridhet-skocia-uellsi-dhe-irlanda-e-ver iut-shkaktoj-i104096
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:03:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:58:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f7aef9a15cccd9a2872f81929e20ae300c55fb048dd1c5a2bde55ef539107707
TEKSTI	55de99d168652fe0ecd1d47d84c8b21209924c8ed93f97b33b71b5d240f71324
PAMJA	039fed9764a52ec2b062d7f000fe84f7f51778b8acc43afe6fd89f5bfc045ce6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	07bb3eddbdd30cb97437479a88b03fa7f323509bfe69bb6e8e6c69c95e843d38
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/07bb3eddbdd30cb97437479a88b03fa7f323509bfe69bb6e8e6c69c95e843d38

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **Uellsit dhe Veriut, të mbledhur sot në Cardiff** ■ **Bardhi: Nëse** Gazment Bardhi, ka reaguar në prag të ■ **kërkohet dorëheqja e** "Skënderbeu" nga ku protestuesit ■ **temje, shkolla mbvll**

BOTA

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uellsit dhe Irlanda e Veriut shkaktojnë “tërmet” në Britaninë e Madhe

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 19:58



Udhëheqësit e Skocisë, Uellsit dhe Irlandës së Veriut, të mbledhur sot në Cardiff, nënshkruan një deklaratë të përbashkët, në të cilën afirmojnë “të drejtën e tyre për vetëvendosje” dhe deklarojnë se e ardhmja e kombeve të tyre “qëndron në Bashkimin Evropian”.

Takimi i paprecedentë u zhvillua pasi Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, habiti botën gjatë fundjavës duke deklaruar se bashkimi i Republikës së Irlandës me Irlandën e Veriut do të ishte “një gjë fantastike”.

Skocia, Uellsit dhe Irlanda e Veriut tani qeverisen nga parti që mbështesin pavarësinë ose ndryshime të mëdha kushtetuese në raport me Mbretërinë e Bashkuar. Ky është një rast i paprecedentë që nga viti 1999, kur në këto vende u krijuan institucionet e vetëqeverisjes, përfshirë parlamentet dhe qeveritë lokale.

Në takim morën pjesë John Swinney, kryeministri i Skocisë dhe lideri i Partisë Kombëtare Skoceze (SNP), Michelle O'Neill, ministrja e parë e Irlandës së Veriut dhe zëvendëskryetaria e Sinn Féin, si dhe Rhun ap Iorwerth, lideri i Plaid Cymru në Uells.

“Kombet tona kanë të drejtën e vetëvendosjes”, thuhet në marrëveshjen e nënshkruar nga liderët. “Ne i bëjmë thirrje qeverisë britanike të përgatisë dhe lehtësojë reformat kushtetuese”, shtuan ata, duke deklaruar bindjen e tyre se “e ardhmja e kombeve tona qëndron brenda BE-së”, pasi Brexit-i “goditi” ekonominë e tyre.

Qeveritë e njëpasnjëshme britanike kanë kundërshtuar mbajtjen e referendumeve të reja për pavarësinë e Skocisë që nga referendumi i vitit 2014, kur 55% e votuesve votuan kundër shkëputjes nga Mbretëria e Bashkuar.

Javën e kaluar, Downing Street përjashtoi mundësinë e një referendumi të ri, duke theksuar se kryeministri britanik “beson fuqimisht në Unionin” e Mbretërisë së Bashkuar.

Megjithatë, Trump parashikoi gjatë fundjavës se “përfundimisht” bashkimi i Irlandës me Irlandën e Veriut do të ndodhte.

Sinn Féin po bën thirrje për mbajtjen e një referendumi deri në vitin 2030.

Sipas Michelle O'Neill, deklaratat e presidentit amerikan tregojnë se “diskutimi rreth bashkimit është i gjallë dhe njerëzit janë shumë të interesuar”, jo vetëm në nivel lokal, por edhe “në shkallë ndërkombëtare”.

“Qëllim i largët”

Në një konferencë për shtyp në Cardiff, liderët e mbledhur theksuan se kombet e tyre do të ecin me ritmin e tyre drejt vetëvendosjes. John Swinney, kryeministri i Skocisë, tha se një referendum për pavarësinë e Skocisë duhet të mbahet brenda pesë viteve të ardhshme.

Në Uells, Rhun ap Iorwerth, i zgjedhur në maj, tha se pavarësia ishte një “qëllim i largët”. Ai nuk caktoi një afat kohor për një referendum, duke thënë se “preferonte ta linte çështjen në duart e popullit uellsian”, por tha se kishte “prova gjithnjë e më të shumta se qeverisja nga Westminster-i (qeveria qendrore) nuk po funksionon”.

Kryeministri aktual britanik, Andy Burnham, i cili deri vonë ishte kryetar i bashkisë së Mançesterit të Madh, e ka bërë prioritet zgjerimin e decentralizimit. Por, sipas Rhun ap Iorwerth, “transferimi i pushteteve të një komb është krejtësisht i ndryshëm nga ai i një rajoni ose një qyteti në Angli”.

Për Michael Keating, profesor i shkencave politike në Universitetin e Aberdeenit në Skoci, deklaratat e përbashkët e tre liderëve është “politikisht e rëndësishme”, pasi për shumë vite SNP dhe Plaid Cymru kanë mbajtur distancë nga Sinn Féin, krahu politik i IRA-s. Megjithatë, “kjo nuk ka gjasa të ndryshojë qëndrimin e qeverisë britanike”, vuri në dukje ai. /PiranjatNews/

Artikuj te sugjeruar

BOTA 14 Shtator19:54

[Aeroporti i Katanias mbyllet për shkak të tymit dhe hirit nga vullkani Etna](#)

Aeroporti i Katanias në Sicili u mbyll përkohësisht sot për shkak të aktivitetit të malit Etna ndërsa vullkani gjëmoi du...

BOTA 14 Shtator19:08

[Detaje nga vdekja e Giorgos Mazonakis/ Zbulohen dy foto dhe një video e fshirë nga telefoni i mjekes](#)

Të dhëna të reja digjitale dhe veçanërisht të rëndësishme për orët e fundit para vdekjes së Giorgos Maz...

BOTA 14 Shtator19:01

[I mbijetoi Auschwitzit dhe jetoi 107 vjet, ndahet nga jeta i mbijetuari më i vjetër i Holokaustit në Izrael](#)

Yehuda Aharon Widawski, i konsideruar si i mbijetuari më i vjetër i Holokaustit në Izrael, është ndarë nga jeta në moshë...

BOTA 14 Shtator18:23

[Pse dy ish-politikanë austriakë të përfolur për korrupsion vrapojnë pas autokratit serb?](#)

Para se të varroset kriminelin e luftës Ratko Mladici, në Serbi qëndruan dy politikanë austriakë: Johannes Hahn, kryetar i Kës...

BOTA 14 Shtator18:12

[Nga Amsterdami e Venecia deri te Miami/ 10 qytetet që rrezikojnë të zhduken deri në vitin 2050](#)

Mbi 570 qytete bregdetare dhe 800 milionë banorë janë në rrezik për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe fundosjes s...

BOTA 14 Shtator18:06

[Takimi më rrjetet sociale kthehet në ‘ferr’ për 22-vjeçaren. I riu e fut në bodrum dhe e abuz*n për orë të tëra](#)

Ai dyshohet se e rrëmbeu për disa orë në një bodrum dhe e detyroi të përjetonte dhunë fizike dhe akte seksuale të p...

BOTA 14 Shtator17:40

[Takimi në Tinder që alarmoi NATO-n, oficeri spanjoll nën hetim pas lidhjes me një grua të lindur në ish-Bashkimin Sovjetik](#)

Një njohje përmes aplikacionit të takimeve Tinder është kthyer në një çështje sigurie për NATO-n, pasi nj&...

BOTA 14 Shtator16:18

[“Ai do të ishte krenar”/ Kryeministri britanik humb babain që vuante nga Alzheimeri](#)

Kryeministri britanik Andy Burnham është në zi pas vdekjes së babait të tij, Roy Burnham, i cili vuante prej vitesh nga sëmundja e...

BOTA 14 Shtator16:06

[Finlanda do t'i bashkohet mbrojtjes bërthamore të Macronit](#)

Finlanda ka vendosur t'i " bashkohet" armës parandaluese bërthamore "të përparuar&rd...

Piranjat News BOTA 14 Shtator11:37

[Ku përfundojnë makinat e vjedhura në Greqi?](#)

Një makinë zhduket nga një rrugë e Athinës brenda pak minutash. Pronari njofton policinë, raporton vjedhjen dhe pret. Pyetja the...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...](#)

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë ...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos. Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

INVESTIGIME 31 Maj 14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!





Reagon Cllevio!



Matilda, Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Deklarata e Gjështit!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.